

EDMOND ÇALI

**VARIANTET E AUTORIT NË POEMËN “PËRSE MENDOHEN
KËTO MALE” TË ISMAIL KADARESE**

1. Në këtë punim shqyrtojmë variantet e autorit në poemën *Përse mendohen këto male* të I. Kadaresë. Kemi zgjedhur këtë poemë sepse është një nga veprat në vargje më të rëndësishme dhe më të arrira të I. Kadaresë dhe sepse studimi i varianteve të autorit na jep mundësinë të kuptojmë mesazhin artistik të poemës, stilin e autorit, mënyrën e tij të shkrimit, vendin e saj në sistemin letrar të I. Kadaresë dhe vendin e saj në letërsinë shqiptare moderne dhe bashkëkohore. Do të paraqesim shkurt botimet e poemës dhe në vijim do të analizojmë ndërhyrjet e autorit¹. Studimi i varianteve të autorit të kësaj poeme është i domosdoshëm sepse nuk kemi ende një botim kritik të saj.

2. Ky punim është pjesë e punimeve tona mbi veprën e I. Kadaresë. Kemi shqyrtuar variantet e autorit edhe në romanin *Dasma*². Kritika shqiptare është marrë me këtë vepër përpara dhe pas vitit 1990. Madje në ndonjë rast ka prekur edhe temën e ndërhyrjeve të autorit në këtë tekst³. Poema është botuar në gazetën *Zëri i popullit*, në revistën *Nëndori*, në përmbledhje, në antologji të letërsisë shqipe si edhe në serinë e veprave të zgjedhura⁴ të I. Kadaresë. Do të shohim ndryshimet strukturore,

¹ Në këtë punim do të përdorim këto sigla dhe shkurtime: ZP 64: ZËRI 1964; NËNDORI 64: NËNDORI 1964; PMKM 64: KADARE 1964; PMKM 66: KADARE 1966; PMKM 75: KADARE 1975; PMKM 76: KADARE 1976; PMKM 79: KADARE 1979; KADARE 81: KADARE 1981; VEPRA 2008: KADARE 2008; FSHS: Fjalor i shqipes së sotme (me rreth 34.000 fjalë), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1984; FGJSH: Fjalor i gjuhës shqipe, Instituti i Shkencave të Shkencave të Gjuhës e i Letërsisë, Tiranë, 1954; k.: kënga; v.:vargu.

² ÇALI 2015a, ÇALI 2015b, ÇALI 2016, ÇALI 2018.

³ Për këtë shiko BIHIKU 1981. Nga i njëjti autor shiko edhe BIHIKU 1983; shiko edhe KALLULLI 1968.

⁴ Shiko: ANTOLOGJI 1969, ANTOLOGJI 1970, ANTOLOGJI 1971, KADARE 1978, KADARE 1979, KADARE 1980, ANTOLOGJI 81.

ndryshimet përmbajtësore, fonetike, morfologjike, leksikore, sintaksore dhe të shenjave të pikësimit.

3. Poema botohet për herë të parë në gazetën *Zëri i popullit* të datës 22 mars 1964⁵. Titulli zë tre rreshta: ISMAIL KADARE / Përse mendohen këta male / POEME. Poema zë pothuajse gjithë f. 3 të gazetës. Është një botim i plotë. Poema ka 303 vargje. Ka 24 këngë të pajisura me numër rendor. Teksti është renditur në tri kolona. Në kolonën e parë janë 8 këngët e para dhe 4 vargjet e para të këngës 9. Në kolonën e dytë janë 19 vargjet e tjera të këngës 9, këngët 10-16 dhe 4 vargjet e para të këngës 17. Në kolonën e tretë janë 9 vargjet e tjera të këngës 17 dhe këngët 18-24. Në fund të poemës, në fundin e kolonës së tretë, pas këngës 24 kemi të dhënat për kohën e shkrimit të poemës: 1962-1963. Kënga 1 ka 13 vargje, kënga 2 ka 6 vargje, kënga 3 ka 17 vargje, kënga 4 ka 19 vargje, kënga 5 ka 9 vargje, kënga 6 ka 13 vargje, kënga 7 ka 7 vargje, kënga 8 ka 10 vargje, kënga 9 ka 23 vargje, kënga 10 ka 12 vargje, kënga 11 ka 13 vargje, kënga 12 ka 19 vargje, kënga 13 ka 13 vargje, kënga 14 ka 13 vargje, kënga 15 ka 5 vargje, kënga 16 ka 5 vargje, kënga 17 ka 13 vargje, kënga 18 ka 14 vargje, kënga 19 ka 11 vargje, kënga 20 ka 11 vargje, kënga 21 ka 9 vargje, kënga 22 ka 11 vargje, kënga 23 ka 11 vargje, kënga 24 ka 26 vargje. Në fund të poemës kemi edhe kohën e shkrimit: 1962-1963.

4. Botimi i dytë, menjëherë pas botimit të parë, bëhet në revistën *Nëndori*⁶. Që në f. 3 të revistës, tek përmbajtja e saj lajmërohem se poema e I. Kadesë fillon në f. 83 (Ismail Kadare – Përse mendohen këto male, poemë. 83). Titullin e poemës e kemi në f. 83 në tre rreshta: ISMAIL KADARE / Përse mendohen këta male / poemë. Siç e shohim kemi një ndryshim me titullin e poemës të dhënë tek përmbajtja e revistës: në përmbajtje kemi formën e gjinisë femërore të përemrit dëftor “këto”, kurse në f. 83 kemi formën e gjinisë mashkullore, shumës “këta”. Poema zë ff. 83-91 të revistës. Poema ka 302 vargje. Ka 24 këngë të pajisura me numër rendor nga 1 deri në 24. Kënga 1 ka 13 v., është në f. 83; kënga 2, 6 v., është në f. 83; kënga 3, 17 v., ff. 83-84; kënga 4, 19 v., f. 84; kënga 5, 9 v., ff. 85-86; kënga 6, 13 v., f. 85; kënga 7, 7 v., f. 85; kënga 8, 10 v., f. 85; kënga 9, 22 v., ff. 85-86; kënga 10, 12 v., f. 86; kënga 11, 13 v., ff. 86-87; kënga 12, 19 v., f. 87; kënga 13, 13 v., f. 87; kënga 14, 13 v., f. 88; kënga 15, 5 v., f. 88; kënga 16, 5 v., f. 88; kënga 17, 13 v., f. 88; kënga 18, 14 v., f. 89; kënga 19, 11 v., f. 89; kënga 20, 11 v., ff. 89-90; kënga 21, 9 v., f.

⁵ ZP 64.

⁶ NËNDORI 64.

90; kënga 22, 11 v., f. 90; kënga 23, 11 v., f. 90; kënga 24, 26 v., f. 91. Në f. 91, në fund të poemës, kemi edhe vitet e kohës së shkrimit: 1962-1963. Kemi disa ndryshime nga botimi i parë. Numri i këngëve dhe përmbajtja e tyre përputhen. Por në këngën 9 kemi eliminimin e vargut 11 “Te koka,”. Kështu kënga 9 ka një varg më pak dhe poema një varg më pak. Ndërhyrjet më të shumta kanë të bëjnë me shenjat e pikësimit. Përsa u përket ndryshimeve strukturore këto kanë të bëjnë kryesisht vetëm me ndarjen e këngëve në strofa. *Fillojmë me ndryshimet e ndarjes së këngëve në strofa*⁷. Kënga 3, 17 v., nuk kemi ndarje në strofa] dy strofa: 11v.+6 v.; kënga 10, 12 v., dy strofa: 6 v. + 6 v.] 12 v., nuk kemi ndarje në strofa; kënga 12, 19 v., tri strofa: 8 v. + 6 v. + 5 v.] 2 strofa: 8 v. + 11 v.; kënga 18, 14 v., tri strofa: 4 v. + 6 v. + 4 v.] 14 v., dy strofa: 10 v. + 4 v.; kënga 21, 9 v., dy strofa: 7 v. + 2 v.] 9 v., nuk kemi ndarje në strofa; kënga 22, 11 v., dy strofa: 4 v. + 7 v.] 11 v., nuk kemi ndarje në strofa. Kënga 24: ndryshon ndarja në strofa, vargu i parë i strofës së katërt bëhet vargu i fundit i strofës së tretë (Atavizmë krenare e kohrave të para.)

Kemi *ndryshime fonetike*. Japim vetëm disa shembuj. Për çdo shembull japim numrin e këngës dhe numrin e vargut: 12/8 s’ka ëndëruar] s’ka ëndërruar; 12/9 Ëndëroje] Ëndërroje;; 12/12 Ëndëroje] Ëndërroje; 13/8 Një ëndër] Një ëndërr; 15/2 rëzon] rrëzon; 18/2 qërronin] qëronin; 12/18 lumtëri] lumturi; 12/19 lumtëri] lumturi;; 14/7 Monarqija] Monarkia; 14/9 Me valiçe] Me valixhe; 23/3 hypnin] hipnin; 24/19 i patrëmbur] i patrembur. Kemi *ndryshime morfologjike*: 3/1 rrebeshet] rrebeshët, 13/1 pillnin mëngjezet] pillnin mëngjezët, 20/4 të manastireve] të manastirëve, ndryshon forma e shumësit të emrit, kalohet nga prapashtesa –ë në prapashtesën –e; 3/4 dejët] dejet, ndryshon forma e shumësit në rasën emërore, trajta e shquar; 24/10 të ulnin kokët.] të ulnin kokat., ndryshon forma e shumësit të emrit në rasën kallëzore, trajta e shquar, kalohet nga prapashtesa –a në prapashtesën –ë të shumësit, kalohet nga forma e normës në një formë jo të normës; 12/2 Nga uriya] Nga uria, 23/4 uriya] uria; 23/7 qetësija] qetësia ; 13/5, 13/10, 15/3, 20/9, 23/10 Shqipërija] Shqipëria; 14/7 Monarqija] Monarkia; 18/3 Zanave, shtojzavalleve ju delnin kokallat] Zanave, shtojzavalleve iu delnin kokallat;; 18/11 Në shtëpitë publike që ju qepeshin maleve] Në shtëpitë publike që iu qepeshin maleve; në këta shembuj ndryshon forma e trajtës së shkurtër të përemrit vetor, veta e tretë, numri shumës, rasa dhanore, kalohet nga një formë jo e normës në një formë tjetër jo të normës, forma e duhur është u; 3/2 I dalin rrënjët rrëpirave.] U dalin rrënjët rrëpirave. , ndryshon trajta e

⁷ Në të gjitha çiftet e shembujve që japim për krahasimin e këtyre dy botimeve forma e parë është ajo e NËNDORI 64, kurse forma e dytë e ZP 64.

shkurtër e përemrit vetor në rasën dhanore, kalohet nga veta e tretë e numrit shumës në vetën e tretë të numrit njëjës. Me këtë ndryshim na mbetet jo i qartë referimi: u – u referohet rrëpirave, kurse i- i referohet tokës; 24/6 po bije] po bie, ndryshon forma e foljes së parregullt *bie* në vetën e tretë, numri njëjës, koha e tashme e mënyrës dëftore, kalohet nga forma e normës në një formë jo të normës.

Ndryshime sintaksore: 12/19 Pak lumtëri që ti e ëndëroje pas një parmënde.] Pak lumturi, që ti e ëndëroje pas një parmënde. Eliminohet presja para fillimit të fjalisë me nënrenditje përcaktore.

Ndryshon përdorimi i shenjave të pikësimit: kemi eliminime dhe zëvendësime. Eliminohet presja: 1/6 e pushkës] e pushkës, ; 1/10 në kokë] në kokë, ; 4/11 Se gruaja lindi fëmijë] Se gruaja lindi fëmijë, ; 6/10 Se në pyjet e tua] Se në pyjet e tua,

eliminohet pika: 3/7 Pak fushë] Pak fushë. ; 3/13 Ata të suleshin] Ata të suleshin.; 4/4 Nga supet kockë e lëkurë] Nga supet kockë e lëkurë.; 8/6 nëpër natë] nëpër natë.

eliminohet pikëpresja: 3/15 Në ije të nguleshin] Në ije të nguleshin; 8/4 duke u lëkundur] duke u lëkundur;

eliminohet pikëçuditja: 4/8 Oh, atë yndyrë të paktë] Oh, atë yndyrë të paktë!

zëvendësohet pikëçuditja me pikë: 3/9 Shekujt të lanë.] Shekujt të lanë!; 3/11 Ku mundën të të hanë.] Ku mundën të të hanë! ; 12/8 njeri.] njeri!

zëvendësohet pika me presje: 5/3 Të lëvizur nga nata,] Të lëvizur nga nata.

5. Botimi i tretë⁸ i poemës “Përse mendohen këto male” bëhet në vëllimin *Përse mendohen këto male (Vjersha dhe poema)*. Jemi sërish në vitin 1964. Vetë botimi është provë e suksesit të veprës në vargje të I. Kadaresë. Vëllimi botohet në 2000 kopje. Poema zë ff. 45-56 të vëllimit. Poema ka 302 vargje. Ka 24 këngë. Kënga 1 ka 13 v. dhe është në f. 45 të librit (është e ndarë në 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 2 ka 6 v., f. 46; kënga 3 ka 17 v., f. 46 (është e ndarë në 3 strofa: me 4, 7 dhe 6 v.) ndryshe nga botimi në revistën *Nëndori* ku kishte dy strofa: me 4 v. dhe 13 v., pra kemi një ndryshim strukturor; kënga 4 ka 19 v., f. 47, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.); kënga 5 ka 9 v., ff. 47-48; kënga 6 ka 13 v., f. 48, (është e ndarë në 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 7, 7 v., ff. 48; kënga 8, 10 v., f. 49; kënga 9, 23 v., ff. 49-50 (është e ndarë në 3 strofa: me 4, 10 dhe 9 v.); kënga 10, 12 v., f. 50 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.); kënga 11, 13 v., ff. 50-51 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 12, 19 v., f. 51 (ka 3 strofa: me 8, 6 dhe 5 v.); kënga 13, 13 v., f. 52; kënga 14, 13 v., f. 52 (ka 2 strofa: me 7 dhe 6 v.); kënga 15, 5 v., f. 53; kënga 16, 5 v., f. 53; kënga 17,

⁸ PMKM 1964.

13 v., f. 53 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 18, 14 v., f. 54 (ka 3 strofa: me 4, 6 dhe 4 v.); kënga 19, 11 v., f. 54 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 20, 11 v., f. 55 (ka 2 strofa: me 5 dhe 6 v.); kënga 21, 9 v., f. 55 (ka 2 strofa: me 7 dhe 2 v.); kënga 22, 10 v., ff. 55-56 (ka 2 strofa: me 4 dhe 6 v.), ka një varg më pak se sa kënga 22 e botimit në *Nëndori* sepse v. 9 dhe v. 10 i botimit të *Nëndorit* janë bashkuar në një varg të vetëm në këtë botim, pra kemi një ndryshim strukturor; kënga 23, 11 v., f. 56 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 24, 26 v., ff. 56-57 (ka 4 strofa: me 10, 7, 4 dhe 5 v.). Në f. 57, në fund të poemës, kemi edhe vitet e kohës së shkrimit: 1962-1964. Shohim se këtu kemi një ndryshim në krahasim me NËNDORI 1964: koha e shkrimit të poemës ndryshon: 1962-1964] 1962-1963⁹.

Ndryshimet fonetike: s-z, 2/5 Drejt një mëngjesi] Drejt një mëngjezi; 13/1 mëngjeset] mëngjezet; r-rr, 6/11 u nxorën] u nxorrën; 13/9 të shterur] të shterrur; 14/7 u thyente ëndërimet] u thyente endërrimet; rr-r, 9/9 Një grumbull gurrësh] Një grumbull gurësh; 15/2 rrëzon] rëzon; o-a, 18/3 shtojzovalleve] shtojzavalleve (rasa dhanore); 18/6, 19/1 shtojzovallet] shtojzavallet; sh-ç, 9/1 me shpikjet,] me çpikjet; 17/5 të shponin] të çponin.

Ndryshimet morfologjike. Ndryshon forma e kohës së pakryer të mënyrës dëftore: 5/4 ç’thoshin] ç’thoshnin. Ndryshon gjinia e mbiemrit në numrin shumës: 9/17 pas gjymtyrëve të gjata] pas gjymtyrëve të gjatë; 10/2 të zeza] të zes (netët); 10/2 mitologjike;] mitologjikë. Dhe kështu kemi formën e normës që përputhet me gjininë e emrit në numrin shumës. Ndryshon nyja shquese e emrit: 12/2, 23/4 uria] uri; 10/1, 13/5, 13/10, 15/3, 20/9, 23/10 Shqipëria] Shqipërija; 23/7 qetësia] qetësija. Ndryshon forma e shumësit e emrit: 24/10 të ulnin kokat] të ulnin kokët. Ndryshon gjinia e përemrit dëftor në numrin shumës: 24/1 këto male] këta male. Ndryshon forma e trajtës së shkurtër të bashkuar të përemrit vetor: 11/12 Më të gjatë shtatin ja bënte pushka] Më të gjatë shtatin ia bënte pushka; 11/13 jetën më të shkurtër ja bënte.] jetën më të shkurtër ia bënte.

Ndryshime leksikore: 3/10 Shekujt] Armiqtë; 9/2 të qytetërimit,] të civilizimit; 9/5 pas luftrave] pas marshimeve; 9/14 Një këngë monotone] Një këngë trimërore; 10/9 nënë pesë gishta,] nëpër pesë gishta; 13/5 nga ashpërsi e saj] nga shëmtimi i saj.

⁹ Në çdo çift të dhënave para kllapës katrore janë të PMKM 1964, ato pas kllapës katrore të NËNDORI 64; shifra e parë është numri i këngës, numri i dytë është numri i vargut. Në vijim të punimit të dhënave para kllapës katrore janë të botimit që shqyrtohet, ato pas kllapës katrore të botimit të mëparshëm.

Ndryshim sintaksor: ndryshon tipi i fjalisë në periudhë: 11/1-4 Po ta vrisje në një breg / Në tjetrin dilte, / Sikur mbinte nga toka, / Shqiptari i thatë] Por e vrisje në një breg / Në tjetrin dilte / Sikur mbinte nga toka / Shqiptari i thatë.

Ndryshon përdorimi i shenjave të pikësimit:

shtohet presja: 2/2 e gjata,] e gjata; 6/3, 6/10 e tua,] e tua; 6/11 mobiljet,] mobiljet; 8/1 kufijtë,] kufijtë; 8/3 sytë,] sytë; 8/4 Dhe ngrihej,] Dhe ngrihej; 9/3 të armëve,] të armëve.

Shtohet pikëpresja: 7/1 malarja,] malarja. Zëvendësohet presja me pikëpresje: 1/7 fshatra,] fshatra,. Zëvendësohet pikëpresja me pikë: 8/2 t'atdheut,] t'atdheut;

6. Botimi i katërt i poemës¹⁰ bëhet në vëllimin *Vjersha dhe poema të zgjedhura* në v. 1966 dhe zë ff. 86-97. Vëllimi botohet në 5000 kopje. Libri ka dy pjesë: pjesa e parë titullohet “Vjersha” dhe pjesa e dytë “Poema”. Poema “Përse mendohen këto male” ka 24 këngë të pajisura me numër rendor nga 1 në 24. Ka 302 vargje. Kënga 1, 13 v., f. 86 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 2 ka 6 v., f. 86; kënga 3 ka 17 v., f. 87 (është e ndarë në 3 strofa: me 4, 7 dhe 6 v.); kënga 4 ka 19 v., ff. 87-88, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.); kënga 5 ka 9 v., f. 88; kënga 6 ka 13 v., ff. 88-89, (është e ndarë në 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 7, 7 v., f. 89; kënga 8, 10 v., f. 89; kënga 9, 23 v., ff. 89-90 (është e ndarë në 3 strofa: me 4, 10 dhe 9 v.); kënga 10, 12 v., ff. 90-91 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.); kënga 11, 13 v., f. 91 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 12, 19 v., ff. 91-92 (ka 3 strofa: me 8, 6 dhe 5 v.); kënga 13, 13 v., f. 92; kënga 14, 13 v., ff. 92-93 (ka 2 strofa: me 7 dhe 6 v.); kënga 15, 5 v., f. 93; kënga 16, 5 v., f. 93; kënga 17, 13 v., ff. 93 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 18, 14 v., f. 94 (ka 3 strofa: me 4, 6 dhe 4 v.); kënga 19, 11 v., ff. 94-95 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 20, 11 v., f. 95 (ka 2 strofa: me 5 dhe 6 v.); kënga 21, 9 v., f. 95 (ka 2 strofa: me 7 dhe 2 v.); kënga 22, 10 v., f. 96 (ka 2 strofa: me 4 dhe 6 v.); kënga 23, 11 v., f. 96 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 24, 26 v., ff. 96-97 (ka 5 strofa: me 6, 4, 7, 4 dhe 5 v.). Në fund të poemës, në f. 97 jepet edhe koha e shkrimit: 1962-1964. *Ndryshimet fonetike:* 5/2 e kambanave] e këmbanave; 5/4 kambanat] këmbanat; 1-ll: 6/5 të lustruara] të llustruara; xh-ç: 8/2 Kafshonin supat e xhveshur,] Kafshonin supat e çveshur; r-rr: 9/9 Një grumbull gurësh] Një grumbull gurrësh; 24/16 e tmerëshme gjymtyrë] e tmerrëshme gjymtyrë; rr-r: 12/8 s'ka ëndërruar] s'ka ëndëruar; 12/9, 12/12, 12/19 Ëndërroje] Ëndëroje; 13/8 Një ëndërr,] Një ëndër; 14/7 ëndërrimet.] ëndërimet.; 22/10 nëpër ëndërr] nëpër ëndër; k-q: 14/7 Monarkia] Monarqia; e-i: 14/11 në vjeshtra deziluzionesh,] në vjeshtra diziluzionesh.

¹⁰ PMKM 1966.

Ndryshime morfologjike. Ndryshon forma e shumësit të emrit: 8/1 kafshonin kufitë,] kafshonin kufijtë. Por edhe: 8/6 të maste kufitë] të maste kufitë, dhe mbetet e njëjta formë. 10/10 Duheshin qindra kilometra tela] Duheshin qindra kilometra telash. Ndryshon rasa e emrit, kalohet nga rrjedhorja e pashquar, shumë, në formën e emërores. Ndryshon forma e foljes në të pakryerën e lidhore: 10/3 kërkonte të thoshte] kërkonte të thonte. Ndryshon gjinia e mbiemrit të nyjshëm në numrin shumë: 22/5 vargmalet e tmerrshme] vargmalet e tmerrshëm. Ndryshon forma e trajtës së shkurtër të përemrit vetor. Kalohet nga një formë jo e normës në formën e normës të vetës së tretë, numri shumë, rasa dhanore: 18/3 zanave, shtojzovalleve u delnin kokallat,] zanave, shtojzovalleve ju delnin kokallat,; 18/11 u qepeshin maleve] ju qepeshin maleve.

Ndryshime leksikore: 13/9 Gjithë e saj të shteruar] Gjithë e saj të shterur; 18/5 Ndonjëherë] E shpesh; 24/10 të ulnin kryet.] të ulnin kokat. *Ndryshojnë shenjat e pikësimit.* Shtohet presja: 1/3 buzë mbrëmjes,] buzë mbrëmjes; 5/8 Logjika latine, me fraza të gjata,] Logjika latine me fraza të gjata; 7/4 Dhe, si Saturni,] Dhe si Saturni; 9/10 Dhe, në vend të luleve,] Dhe në vend të luleve; 9/21 Dhe, pas të gjithave,] Dhe pas të gjithave; 11/1 në një breg,] në një breg; 11/5 Dhe, përmbi trup,] Dhe përmbi trup; 11/6 e hekurt,] e hekurt; 11/9 Me të në krahë,] Me të në krahë; 11/12 pushka,] pushka; 12/1 e acarta,] e acarta; 12/18 pak lumtëri,] pak lumtëri; 13/1 mëngjeset,] mëngjeset; 13/5 e saj,] e saj; 13/6 të bukur,] të bukur; 15/4 “Është herët”, tha,] “Është herët” tha,; 18/6 epike,] epike; 22/9 tragjike,] tragjike; 23/1 në shkretëtirë,] në shkretëtirë; 23/5 E, tok me to,] E tok me to; 24/7 së tij,] së tij. Zëvendësohet pika me presje: 5/3 nga nata,] nga nata. Eliminohet presja: 4/11 fëmijë] fëmijë,. Shtohet pika dhe korrigjohet gabimi i shtypit: 8/6 nëpër natë.] nëpër natë.

7. Botimi i pestë i poemës bëhet në vitin 1975¹¹. Është një botim për nxënësit e shkollave: në kapak dhe në ballinë kemi të shkruar “Biblioteka e nxënësit” dhe vëllimi botohet nga Shtëpia botuese e librit shkollor. Kjo ndoshta është arsyeja e tirazhit të lartë për një libër që ka tri poema: 10000 kopje. Përveç poemës “Përse mendohen këto male”, në vëllim kemi edhe poemat “Shqiponjat fluturojnë lart” dhe “Ëndërr industriale”. Poema “Përse mendohen këto male” zë ff. 3-16 të librit. Pas tekstit të poemës, në ff. 17-25, vijojnë “Shënime dhe studim teksti” që përmbajnë shpjegime të tekstit dhe detyra për nxënësit. Nuk e dimë nëse kjo pjesë është hartuar nga të dy autorët, Luan Rexhepi dhe Stefan Kume, që e kanë përgatitur për botim dhe që e kanë pajisur me shënime librin, apo vetëm nga njëri prej tyre. Në këtë botim poema ka 302 vargje. Ka 24 këngë të pajisura me

¹¹ PMKM 1975.

numër rendor nga 1 në 24. Kënga 1 ka 13 v., f. 3 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 2 ka 6 v., f. 4; kënga 3 ka 17 v., f. 4 (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 4, 3 dhe 6 v.); kënga 4 ka 19 v., f. 5, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.); kënga 5 ka 9 v., ff. 5-6; kënga 6 ka 13 v., f. 6, (është e ndarë në 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 7, 7 v., ff. 6-7; kënga 8, 10 v., f. 7; kënga 9, 23 v., ff. 7-8 (është e ndarë në 4 strofa: me 5, 9, 2 dhe 7 v.); kënga 10, 12 v., ff. 8-9 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.); kënga 11, 13 v., f. 9 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 12, 19 v., ff. 9-10 (ka 3 strofa: me 8, 6 dhe 5 v.); kënga 13, 13 v., ff. 10-11; kënga 14, 13 v., f. 11 (ka 2 strofa: me 7 dhe 6 v.); kënga 15, 5 v., f. 11; kënga 16, 5 v., f. 12; kënga 17, 13 v., ff. 12 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 18, 14 v., f. 13 (ka 3 strofa: me 4, 6 dhe 4 v.); kënga 19, 11 v., ff. 13-14 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 20, 11 v., f. 14 (ka 2 strofa: me 5 dhe 6 v.); kënga 21, 9 v., f. 14 (ka 2 strofa: me 7 dhe 2 v.); kënga 22, 10 v., f. 15 (ka 2 strofa: me 4 dhe 6 v.); kënga 23, 11 v., f. 15 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 24, 26 v., f. 16 (ka 5 strofa: me 6, 4, 7, 4 dhe 5 v.). Në fund të poemës nuk kemi kohën e shkrimit, por në fillim të rubrikës “Shënime dhe studim teksti”, në f. 17, kemi disa të dhëna jo të plota për botimin e saj: “Poema “Përse mendohen këto male” është botuar në vitin 1964 dhe ka fituar çmimin e parë në konkursin kombëtar letrar-artistik për nder të 20-vjetorit të çlirimit të atdheut”.

Ky botim nuk është marrë nga botimi i vitit 1966, por nga botimi i vitit 1964.

Ja ndërhyrjet e bëra në tekst në këtë kalim. *Ndryshime fonetike*: 1/8 Hija] Hieja; 24/4 Nën hijen] Nën hien¹²; 2/5 mjegull] mjergull; 5/5 murmurisnin] murmuritnin; 1-ll, 6/5 të lustruara] të llustruara¹³; 7/7 këmbanaret.] kumbonaret; zh-ç, 8/7 e zhveshur] e çveshur; bie ë-ja e patheksuar, 10/5 nga zërat e brendshme,] Nga zërat e brendëshme, ; 16/5 rrebeshet e ardhshme.] rrebeshet e ardhëshme.; 24/16 e tmerrshme] e tmerrëshme; u-ë, 12/7 lumturi,] lumtëri.; 12/18 lumturi,] lumtëri, (po edhe 12/19 lumtëri,] lumtëri.); rr-r, 12/9, 12 Ëndërroje] Ëndëroje; 13/8 Një ëndërr,] Një ëndër.; 14/7 ëndërrimet.] ëndërimet.; 22/10 nëpër ëndërr] nëpër ëndër; v-u, 14/1 të Evropës,] të Europës.; k-q, 14/7 Monarkia,] Monarqia.; xh-ç, 14/9 Me valixhe] Me valiçe¹⁴; 17/7, 9 qejfin,] qefin.; 23/3 hipnin] hypnin; 24/2 jug-veri?] jugë veri?; 24/19 i patrembur] i patrëmbur. *Ndryshime morfologjike*. Ndryshon forma e shumësit të emrit: 3/4 dejet] dejet; 8/2 supet] supat; 8/6 të maste kufijtë] të maste kufitë; 13/9 Gjnjtë]

¹² Forma “hic-ja” gjendet në FGJSH, f. 170, kolona 2. Forma “hij/e-a” gjendet në FSHS, f. 425, kolona 1.

¹³ Në FGJSH në f. 281, kolona 1 gjejmë “lustruj”. Edhe në FSHS, f. 644, kolona 2 gjejmë “lustr-oj, -ova, uar”.

¹⁴ Forma “valixhe-valixhja” gjendet në FGJSH, f. 596, kolona 2.

Gjitë. Ndryshon forma e foljes: 10/8 të thonin] të thoshin; 18/3 dilyn] delnin (por edhe 19/2 dilyn] dilyn); 23/3 hipnin] hypnin; 24/26 po bie] po bije. Ndryshon forma e trajtës së shkurtër të bashkuar të përemrit vetor: 11/12 ia bënte] ja bënte; 11/13 ia bënte.] ja bënte.; 18/3 iu dilyn kokallat,] ju dilyn kokallat.; 18/11 iu qepeshin maleve] ju qepeshin maleve. Ndryshon gjinia e përemrit dëftor: 24/25 këto male] këta male. Ndryshon gjinia e mbiemrit në numrin shumë: 22/5 vargmalet e tmerrshme] vargmalet e tmerrshëm; 24/25 male të larta,] male të lartë. *Ndryshojnë shenjat e pikësimit.* Shtohet presja: 1/1 të lartë,] të lartë; 1/3 mbrëmjes,] mbrëmjes; 1/6 e pushkës,] e pushkës; 3/5 brinjë,] brinjë; 4/11 fëmijë,] fëmijë; 6/1 poetë,] poetë; 9/10 të luleve,] të luleve; 9/11 Te koka,] Te koka; 9/13 i tij,] i tij; 11/1 në një breg,] në një breg; 11/5 përmbi trup,] përmbi trup; 11/6 e hekurt,] e hekurt; 12/1 e acarta,] e acarta; 12/18 lumturi,] lumtëri; 18/12 e lodhura,] e lodhura; 24/25 male të larta,] male të lartë. Eliminohet presja: 3/8 fushë] fushë; 8/3 sytë] sytë; 9/3 të armëve] të armëve; 11/3 nga toka] nga toka; 12/5 gjumi] gjumi.. Zëvendësohet pika me pikëpresje: 4/9 e gjatë;] e gjatë. Zëvendësohet pika me pikëçuditje: 17/5 e poetëve!] e poetëve.; 24/6 Shqipëri!] Shqipëri. Zëvendësohet pika me presje dhe shtohet një gabim shtypi: 17/11 e parë,] e parë.; 19/6 në kisha të braktisura,] në kisha të braktisura. Zëvendësohet presja me pikë: 23/7 e gënjeshtër.] e gënjeshtër..

8. Botimi i gjashtë¹⁵ i poemës bëhet në vitin 1976. Është përmbledhja Ismail Kadare, *Poezia shqipe*. Poema zë ff. 91-105 të vëllimit. Në Pasqyrën e lëndës na jepet përmbajtja e librit dhe na sqarohet se pjesa e tretë (ff. 77-162) e këtij vëllimi përbëhet nga krijime të autorit të marra nga libri “Përse mendohen këto male – 1964. Kemi edhe një gabim shtypi sepse mungojnë thonjëzat në fund të titullit të librit. Poema “Përse mendohen këto male” në këtë botim ka 298 vargje. Ka 24 këngë të pajisura më numër rendor nga 1 në 24. Kënga 1, 13 v., f. 91 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 2 ka 6 v., f. 92; kënga 3 ka 17 v., ff. 92-93 (është e ndarë në 2 strofa: me 11 dhe 6 v.); kënga 4 ka 19 v., f. 93, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.); kënga 5 ka 10 v., f. 94; kënga 6 ka 7 v., f. 94, (është e ndarë në 2 strofa: me 5 dhe 2 v.); kënga 7, 7 v., f. 95; kënga 8, 10 v., f. 95; kënga 9, 23 v., ff. 95-96 (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 8, 2 dhe 9 v.); kënga 10, 12 v., f. 97 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.); kënga 11, 13 v., ff. 97-98 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 12, 19 v., ff. 98-99 (ka 3 strofa: me 8, 6 dhe 5 v.); kënga 13, 13 v., f. 99; kënga 14, 13 v., ff. 99-100 (ka 2 strofa: me 7 dhe 6 v.); kënga 15, 5 v., f. 100; kënga 16, 5 v., f. 100; kënga 17, 13 v., ff. 100-101 (ka 2 strofa: me 5, dhe 8 v.); kënga 18, 14 v.,

¹⁵ PMKM 76.

ff. 101-102 (ka 3 strofa: me 4, 6 dhe 4 v.); kënga 19, 11 v., f. 102 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 20, 11 v., ff. 102-103 (ka 2 strofa: me 5 dhe 6 v.); kënga 21, 9 v., f. 103 (ka 2 strofa: me 7 dhe 2 v.); kënga 22, 10 v., ff. 103-104 (ka 2 strofa: me 4 dhe 6 v.); kënga 23, 12 v., f. 104 (ka 2 strofa: me 6 dhe 6 v.); kënga 24, 26 v., ff. 104-105 (ka 5 strofa: me 6, 4, 7, 4 dhe 5 v.). Në fund të poemës, në f. 105 jepet edhe koha e shkrimit: 1962-1964. Ky botim merret nga botimi i vitit 1966, pra nga PMKM 66. Ndryshon numri i vargjeve: nga 302 vargje të PMKM 66 kalohet në 298 vargje. Ndryshojnë këngët 5 dhe 6. Për këtë shiko tabelën në vijim (tabela 1).

Tabela 1

PMKM 66, f. 88	PMKM 76, 94
5. Rrokulliseshin në pjerrësitë malësore Tingujt e kambanave Të lëvizur nga nata, Ç'thoshin kambanat, Ç'murmuritnin priftërit Në gjuhë të huaja Kishave të larta? Logjika latine, me fraza të gjata, Përpiquej të përkulte pushkën e gjatë.	5. Në këmbët e maleve shtriheshin fushat, Të urta si gratë, si gratë kokulura. Ç'të gatuanin fushat për gjigantët e uritur? Mbi fushë erë vërshëllentë "u", Shtriheshin duaft e rrallë sipër tyre Si të vrrarë, përmbysur aty – këtu. Ndaj malet bubullonin e lëshonin tatëpjetë Gurë e përrenj plot sherr e poterë. Ato, kokunjurat, gjithçka duronin Duke ëndërruar tjetrën verë.
6. Dhe pati poetë Të ulur në mobilje të prera Nga pyjet e tua, Që shkruan për ty të frymëzuar Prej mobiljeve të lustruara Dhe prej biblbilave, Që mbi drurët – etër të mobiljeve Dikur kishin kënduar.	6. Kryqi i Krishtit, gjysmëhëna e Islamit, Peisazhet e tua kërkonin t'i ndanin. Turqishta e Kuranit, e arabëve përçartja, Logjika latine me frazat e gjata Përpiquehin të shkurtonin pushkën e gjatë. Dhe fjalët latinisht dhe fjalët arabisht Mbi tytën e saj binin si ndryshk.

Shohim se fryma antifetare ndryshon. Në PMKM 1966 përmendet vetëm feja e krishterë, kurse në PMKM 1976 edhe feja islamike. Në PMKM 1976 kemi edhe kritikën ndaj poetëve të periudhës para realizmit socialist.

Kemi këto ndryshime të tjera në tekst. *Ndryshime fonetike*: 1/5 hie] hie; 14/10 Nën hie] nën hie; 24/4 Nën hijen] Nën hien. Shtohet përdorimi i ë-së së

patheksuar: 3/1 gërryejnë] grryejnë¹⁶; 3/3 gërryen] grryen; 3/14 e kohërave] e kohrave; 4/18 kohërat] kohrat; 24/8 kohërat,] kohrat.; 24/17 e kohërave] e kohrave; 9/5 pas luftërave] pas lufrave; 18/2 ndanë ujërave,] ndanë ujrave. Bie shkronja ë në fund të fjalës: 10/9 nën pesë gishta] nënë pesë gishta; 24/2 jug – veri?] jugë – veri?; e-ë: 24/7 Njëpërmjet shenjestrës] Njëpërmjet shënjestrës; 24/19 i patrembur] i patrëmbur; 7/7 kambanaret] kumbonaret; zh-xh: 8/2 e zhveshur,] e xhveshur.; r-rr: 9/6 Murana] Murrana; v-u: 14/1 të Evropës,] të Europës.; e-i: 14/11 në vjeshtra deziluzionesh,] në vjeshtra diziluzionesh; bie ë-ja e patheksuar: 16/5 e ardhshme.] e ardhëshme.; 24/16 e tmerrshme] e tmerëshme; ë-u: 17/3 ulërinin.] ulurinin; 17/7, 17/9 qejfin,] qefin; i-y: 18/1 Hymnizonin] Hymnizonin; a-o: 18/1, 19/1 shtojzavallet,] shtojzovallet.; 18/3 shtojzavalleve] shtojzovalleve; 18/6 shtojzavallet] shtojzovallet; i-e: 18/3 dilyn] delnin, por edhe 19/2 dilyn] dilyn; t-th: 19/2, 19/4, 19/7 mitet] mithet; 19/ 11 të miteve.] të mitheve.; 22/5 vargmalet e tmerrshëm] vargmalet e tmershme. *Ndryshim ortografik*, shtohet përdorimi i shkronjës së madhe: 24/12 të Shqiptarit] të shqiptarit. *Ndryshime morfologjike*. Ndryshon forma e shumësit të emrit: 3/4 dejet] dejet; 7/3, 17/2 Priftërinjtë] Priftërit; 8/1 kafshonin kufijtë,] kafshonin kufitë.; 8/6 të maste kufijtë] të maste kufitë. Ndryshon forma e rasës rrjedhore të emrit në shumës, trajta e shquar: 4/17 netve] netëve. Ndryshon gjinia e mbiemrit të nyjshëm në numrin shumës: 10/5 Nga zërat e brendshëm,] Nga zërat e brendëshme; 22/5 vargmalet e tmerrshëm] vargmalet e tmershme. Ndryshon forma e trajtës së shkurtër të përemrit vetor: 11/12, 13 ia bënte] ja bënte. Shtohet trajta e shkurtër e përemrit vetor: 17/7 për të të bërë qejfin,] për të bërë qefin,. Ndryshon forma e përemrit pronor: 12/16 në mes mynxyrës sate] në mes mynxyrës tënde. Ndryshon gjinia e përemrit dëftor në numrin shumës: 24/1, 24/26 këto male] këta male. Ndryshon forma e foljes: 18/3 dilyn] delnin; 24/26 po bie] po bije. Ndryshime leksikore: 15/1, 2 e hershme] e herëta; 19/6 në depo të braktisura.] në kisha të braktisura.

Ndryshojnë shenjat e pikësimit. Shtohet presja: 1/6 e pushkës,] e pushkës.

9. Botimi i shtatë¹⁷ i poemës del në vëllimin e dytë të serisë së veprave të I. Kadaresë të botuara në Tiranë në v. 1981. Poema zë ff. 77-90 të vëllimit. Ka 298 vargje. Ka 24 këngë të pajisura më numër rendor nga 1 në 24. Kënga 1, 13 v., f. 77 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.); kënga 2 ka 6 v., f. 78; kënga 3 ka 17 v., f. 78 (është e ndarë në 2 strofa: me 11 dhe 6 v.); kënga 4 ka 19 v., f. 79, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.); kënga 5 ka 10 v., ff. 79-80 (është e ndarë në dy strofa: me 6 dhe 4 v.);

¹⁶ Formën “gërryej” e gjejmë në FGJSH, f. 140, kolona 1-2.

¹⁷ KADARE 81.

kënga 6 ka 7 v., f. 80; kënga 7, 7 v., f. 80; kënga 8, 10 v., f. 81; kënga 9, 23 v., ff. 81-82 (është e ndarë në 3 strofa: me 5, 7 dhe 11 v.); kënga 10, 12 v., f. 82 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.); kënga 11, 13 v., ff. 82-83 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.); kënga 12, 19 v., ff. 83-84 (ka 3 strofa: me 8, 6 dhe 5 v.); kënga 13, 13 v., f. 84; kënga 14, 13 v., ff. 84-85 (ka 2 strofa: me 7 dhe 6 v.); kënga 15, 5 v., f. 85; kënga 16, 5 v., f. 85; kënga 17, 13 v., ff. 85-86 (ka 2 strofa: me 5 dhe 8 v.); kënga 18, 14 v., f. 86 (ka 3 strofa: me 4, 5 dhe 5 v.); kënga 19, 11 v., f. 87 (ka 2 strofa: me 6 dhe 5 v.); kënga 20, 11 v., f. 87 (ka 2 strofa: me 5 dhe 6 v.); kënga 21, 9 v., f. 88 (ka 2 strofa: me 7 dhe 2 v.); kënga 22, 10 v., f. 88 (ka 2 strofa: me 8 dhe 2 v.); kënga 23, 12 v., f. 89 (ka 2 strofa: me 6 dhe 6 v.); kënga 24, 26 v., ff. 89-90 (ka 5 strofa: me 6, 4, 7, 4 dhe 5 v.). Në fund të poemës, në f. 90 jepet edhe koha e shkrimit: 1962-1964.

Ndryshime fonetike: 1/6, 1/8, 1/12 hija] hieja; 12/7, 12/18 lumturi,] lumtëri,; bie ë-ja e patheksuar: 12/16 Shkreptima] Shkrepëtima; shtohet ë-ja: 17/13 dregëza,] dregza,; xh-ç: 14/9 Me valixhe] Me valiçe; o-a: 18/1, 19/1 shtojzovallet,] zhtojzavallet,; 18/3 shtojzovalleve] shtojzavalleve; 18/6 shtojzovallet] shtajzavallet; i-y: 23/3 hipnin] hypnin; ë-e: 24/7 shënjestrës] shenjestrës; 24/17 Atavizëm] Atavizëm.

Ndryshime morfologjike. Ndryshon forma e numrit shumës të emrit: 3/4 dejtë] dejet; 3/5 Dej, dej] Deje, deje; 8/2 supet] supat; 13/9 Gjnjtë] Gjitë; 24/8 kohët,] kohërat,; 24/17 e kohëve] e kohërave.

Ndryshon gjinia e emrit: 14/7 gurëthyese] gurëthyes.

Ndryshon gjinia e mbiemrit në numrin shumës: 8/2 e zhveshura] e zhveshur; 8/2 të zbehta] të zbetë; 13/2 Të turbullta,] Të turbullt,; 13/2 të hirta,] të hirtë; 20/4 të manastireve të ftohta] të manastireve të ftohtë; 22/5 vargmalet e tmerrshme] vargmalet e tmerrshëm; 22/7 Të verbra,] Të verbër; 22/8 Të frikshme.] Të frikshëm; 22/9 të trembura] të trembur; 24/25 këto male të larta,] këto male të lartë.

Ndryshon përdorimi i trajtës së shkurtër të përemrit vetor: 17/7 për të bërë qejfin,] për të të bërë qejfin,.

Ndryshim leksikor: 23/1 karnavali] karvani.

Ndryshon shenja e pikësimit. Zëvendësohet pika me pikëçuditje: 17/5 e poetëve!] e poetëve.

Eliminohet presja: 18/8 zbrisnin] zbrisnin,

Eliminohet përdorimi i shkronjës së madhe: 24/12 të shqiptarit] të Shqiptarit.

Korrigjohet një gabim shtypi: 6/3 Turqishtja] Turqishta.

10. Botimi i tetë¹⁸ i poemës del në Tiranë në v. 2008, në vëllimin e shtatë të veprave të I. Kadaresë të botuara nga shtëpia botuese “Onufri”. Poema zë ff. 177-186 të vëllimit. Ka 214 vargje. Ka 15 këngë të pajisura më numër rendor nga 1 në 15. Siç e shohim ulet numri i këngëve të poemës: zbret nga 24 në 15. Pra janë 9 këngë më pak. Eliminohen gjithsej 7 këngë: kënga 6, kënga 8, kënga 12, kënga 17, kënga 19, kënga 21 dhe kënga 23 të KADARE 1981. Kurse kënga 15 dhe kënga 16 të KADARE 1981 i bashkohen këngës 14 të KADARE 1981 dhe janë kënga 11 e VEPRÄ 2008.

Kënga 1 e VEPRÄ 2008 1, ka 13 v., f. 177 (ka 3 strofa: me 5, 6 dhe 2 v.), përputhet me këngën 1 të KADARE 1981; kënga 2 e VEPRÄ 2008 ka 6 v., ff. 177-178, përputhet me këngën 2 të KADARE 1981; kënga 3 e VEPRÄ 2008 ka 17 v., f. 178 (është e ndarë në 2 strofa: me 11 dhe 6 v.), përputhet me këngën 3 të KADARE 1981; kënga 4 e VEPRÄ 2008 ka 19 v., ff. 178-179, (është e ndarë në 4 strofa: me 4, 6, 5 dhe 4 v.), përputhet me këngën 4 të KADARE 1981; kënga 5 e VEPRÄ 2008 ka 10 v., ff. 179-180, përputhet me këngën 5 të KADARE 1981; kënga 6 e VEPRÄ 2008 ka 7 v., f. 180, përputhet me këngën 7 të KADARE 1981; kënga 7 e VEPRÄ 2008, 22 v., ff. 180-181 (është e ndarë në 2 strofa: me 4, dhe 18 v.), përputhet me këngën 9 të KADARE 1981; kënga 8 e VEPRÄ 2008, 12 v., f. 181 (ka 3 strofa: me 6, 3 dhe 3 v.) dhe përputhet me këngën 10 të KADARE 1981; kënga 9 e VEPRÄ 2008, 13 v., f. 182 (ka 2 strofa: me 8 dhe 5 v.) përputhet me këngën 11 të KADARE 1981; kënga 10 e VEPRÄ 2008, 11 v, ff. 182-183, përputhet me këngën 13 të KADARE 1981; kënga 11 e VEPRÄ 2008, 22 v., f. 183, përmban këngët 14, 15 dhe 16 të KADARE 1981 (ka 2 strofa: 12 dhe 10 v.); kënga 12 e VEPRÄ 2008, 14 v, f. 184, (ka 2 strofa: 4 dhe 10 v.) përputhet me këngën 18 të KADARE 1981; kënga 13 e VEPRÄ 2008 ka 11 v., ff. 184-185 (ka 2 strofa: 5 dhe 6 v.) përputhet me këngën 20 të KADARE 1981; kënga 14 e VEPRÄ 2008, 10 v., f. 185 (ka 2 strofa: me 8 dhe 2 v.) përputhet me këngën 22 të KADARE 1981; kënga 15 e VEPRÄ 2008, 26 v., ff. 185-186, (ka 5 strofa: me 6, 4, 7, 4 dhe 5 v.) dhe përputhet me këngën 24 të KADARE 1981. Në fund të poemës, në f. 186 jepet edhe koha e shkrimit: 1962-1964.

Kemi edhe *një ndryshim tjetër strukturor*: vargjet 3 dhe 4 të këngës 14 të KADARE 1981 (Erdhën /Një nga një,) bashkohen në një varg të vetëm, dhe bëhen vargu 3 i këngës 11 të VEPRÄ 2008.

Përveç këtyre eliminimeve të rëndësishme kemi këto ndryshime.

¹⁸ VEPRÄ 2008.

Ndryshime fonetike: 9/9 në krah,] në krahë 11/9; 11/1 të Europës,] të Evropës, 14/1.

Ndryshime morfologjike. Ndryshon gjinia e mbiemrit në numrin shumës: 1/1, 15,1 male të larta] male të lartë 1/1, 24/1.

Ndryshime ortografike. Shtohet përdorimi i theksit: 1/5 dhé.] dhe.; 15/24 këtë dhé...] këtë dhe 24/24.

Ndryshon shenja e pikësimit, shtohet pika: 11/7 Erdhën.] Erdhën 14/8

11. Si përfundim në NËNDORI 64 kemi ndryshime strukturore (në ndarjen e këngëve në strofa), ndryshime fonetike, morfologjike, sintaksore, ndryshim në përdorimin e shenjave të pikësimit. Në KADARE 1964 kemi ndryshime fonetike, morfologjike, leksikore, sintaksore dhe ndryshim në shenjat e pikësimit. Në KADARE 1966 kemi ndryshime fonetike, morfologjike, ndryshime leksikore dhe në shenjat e pikësimit. Në KADARE 1975 kemi ndryshime fonetike, morfologjike dhe në përdorimin e shenjave të pikësimit. Në KADARE 1976 kemi ndryshime përmbajtësore, sepse ndryshojnë këngët 5 dhe 6; kemi ndryshime fonetike, ndryshime morfologjike dhe në shenjat e pikësimit. Në KADARE 1981 kemi ndryshime fonetike, morfologjike, leksikore dhe në shenjat e pikësimit. Në KADARE 2008 kemi ndryshime thelbësore strukturore dhe përmbajtësore. Në tabelën e mëposhtme (tabela 2) për çdo botim të poemës japim numrin e këngës të pasuar nga numri i vargjeve përkatës. Nënvizojmë numrin e këngës ku ka ndryshime strukturore. Vëmë në dukje numrin e këngës ku ka ndryshim përmbajtësor ose eliminim. Ja shkurt përmbajtja e pjesëve të eliminuara në KADARE 2008. Kënga 6: këtu jepet feja nga këndvështrimi i realizmit socialist. Kënga 8: këtu janë protagonistë atdheu dhe armiqtë e tij; është një nga pikat kulmore e më të arrira artistikisht. Kënga 12: këtu protagonistë janë Shqipëria dhe lidhjet e saj me legjendën dhe ëndrrat e saj. Është një këngë me shumë rëndësi përmbajtësore. Kënga 17: është një eliminim i kuptueshëm; këtu flitet për priftërinjtë dhe poetët e së kaluarës që shihen nga këndvështrimi i realizmit socialist. Kënga 19: flet për mitet. Kënga 21: flet për vargmalet që personifikojnë atdheun dhe shqiptarin. Kënga 23: është kënga më ideologjike e poemës; me këtë eliminim autori eliminon thelbin e poemës si poemë e realizmit socialist. Citojmë vetëm strofën e dytë: Por qetësia ish e gënjeshtër, / Karvani i gjatë i maleve priste / Priste me vite, kish pritur me shekuj, / Ta printe përpara një udhëheqës, / Priste Shqipëria / Partinë Komuniste¹⁹.

Si përfundim na rezulton një orvatje e autorit për ta zbrazur poemën nga brendia e saj prej poeme të realizmit socialist duke i lënë vetëm

¹⁹ KADARE 1981, f. 89.

Variantet e autorit në poemën “Përse mendohen këto male”...

patriotizmin. Vetëm studimi i varianteve të autorit dhe botimi kritik i poemës mund të na garantojnë leximin e këtij teksti poetik.

Tabela 2

ZP 64	NËNDORI 64	PMKM 1964	PMKM 1966	PMKM 1975	PMKM 1976	KADARE 81	VEPRA 2008
k. 1, 13 v.	k. 1, 13 v.	k. 1, 13 v.	k. 1, 13 v.	k.1, 13 v.	k. 1, 13 v.	k. 1, 13 v.	k. 1, 13 v.
k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.	k. 2, 6 v.
k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.	k. 3, 17 v.
k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.	k. 4, 19 v.
k. 5, 9 v.	k. 5, 9 v.	k. 5, 9 v.	k. 5, 9 v.	<u>k. 5, 9 v.</u>	<u>k. 5, 10 v.</u>	k. 5, 10 v.	k. 5, 10 v.
k. 6, 13 v.	k. 6, 13 v.	k. 6, 13 v.	k. 6, 13 v.	<u>k. 6, 13 v.</u>	<u>k. 6, 7 v.</u>	k. 6, 7 v.	
k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 7, 7 v.	k. 6, 7 v.
k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	k. 8, 10 v.	
<u>k. 9, 23 v.</u>	<u>k. 9, 22 v.</u>	<u>k. 9, 23 v.</u>	k. 9, 23 v.	k. 9, 23 v.	k. 9, 23 v.	<u>k. 9, 23 v.</u>	<u>k. 7, 22 v.</u>
k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 10, 12 v.	k. 8, 12 v.
k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 11, 13 v.	k. 9, 13 v.
k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	k. 12, 19 v.	
k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 13, 13 v.	k. 10, 13 v.
k. 14, 13 v.	k. 14, 13 v.	k. 14, 13 v.	k. 14, 13 v.	k. 14, 13 v.	k. 14, 13 v.	<u>k. 14, 13 v.</u>	<u>k. 11, 22 v.</u>
k. 15, 5 v.	k. 15, 5 v.	k. 15, 5 v.	k. 15, 5 v.	k. 15, 5 v.	k. 15, 5 v.	<u>k. 15, 5 v.</u>	
k. 16, 5 v.	k. 16, 5 v.	k. 16, 5 v.	k. 16, 5 v.	k. 16, 5 v.	k. 16, 5 v.	<u>k. 16, 5 v.</u>	
k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	k. 17, 13 v.	
k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 18, 14 v.	k. 12, 14 v.
k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	k. 19, 11 v.	
k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 20, 11 v.	k. 13, 11 v.
k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	k. 21, 9 v.	
k. 22, 11 v.	<u>k. 22, 11 v.</u>	<u>k. 22, 10 v.</u>	k. 22, 10 v.	k. 22, 10 v.	k. 22, 10 v.	k. 22, 10 v.	k. 14, 10 v.
k. 23,	k. 23, 11 v.	k. 23, 11	k. 23, 11	<u>k. 23, 11</u>	<u>k. 23, 12</u>	k. 23, 12 v.	

11 v.		v.	v.	v.	v.		
k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 24, 26 v.	k. 15, 26 v.
303 vargje	302 vargje	302 vargje	302 vargje	302 vargje	298 vargje	298 vargje	214 vargje

BIBLIOGRAFI

a.botime të poemës *Përse mendohen këto male*:

ZËRI 1964: I. Kadare, “Përse mendohen këta male”, poemë, në *Zëri i popullit*, Tiranë 22 mars 1964, f. 3.

NËNDORI 1964: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, poemë, në *Nëndori*, nr. 3 (mars) 1964, ff. 83-91.

KADARE 1964: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Përse mendohen këto male* (vjersha dhe poema), Tiranë, 1964, ff. 45-57.

KADARE 1966: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Vjersha dhe poema të zgjedhura*, Tiranë, 1966, ff. 86-97.

ANTOLOGJI 1969: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Antologji e letërsisë shqipe të realizmit socialist për klasën XI* (Dispensë), Tiranë, 1969, ff. 188-197.

ANTOLOGJI 1970: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Antologji e letërsisë shqipe të realizmit socialist për shkollat e mesme* (Dispensë), Tiranë, 1970, ff. 194-202.

ANTOLOGJI 1971: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Antologji e letërsisë shqipe të realizmit socialist për shkollat e mesme* (Dispensë), Tiranë, 1971, ff. 188-197.

KADARE 1975: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Përse mendohen këto male Shqiponjat fluturojnë lart Ëndërr industriale*, Tiranë, 1975, ff. 3-16, (Shënime dhe studim teksti, ff. 17-25).

KADARE 1976: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Poezia shqipe*, Tiranë, 1976, ff. 91-105.

KADARE 1978: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Motive me diell*, Prishtinë, 1978, ff. 160-172.

KADARE 1979: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Poezi*, Tiranë, 1979, ff. 89-102.

KADARE 1980: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Buzëqeshje mbi botë*, Prishtinë, 1980, ff. 226.

KADARE 1981: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Vepra letrare*, 2, Tiranë, 1981, ff. 77-90.

- ANTOLOGJIA 81: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Antologjia e letërsisë shqiptare (Letërsi e realizmit socialist), për shkollat e mesme*, 2, Ribotim i katërt, Tiranë, 1981 (Botimi i parë: 1979), ff. 184-192 [Janë këngët 1, 2, 3, 4, 7, 8, 10, 11, 12, 21, 22, 23, 24].
- KADARE 2008: I. Kadare, “Përse mendohen këto male”, në *Vepra, Vëllimi i shtatë*, Tiranë, 2008, ff. 177-186.
- b.
- BIHIKU 1981: K. Bihiku, “Nga zhvillimi i poemës shqiptare të realizmit socialist. Poemat e Ismail Kadaresë”, në *Studime filologjike*, 2, 1981, Tiranë, 1981, ff. 3-47, ff. 11-12.
- BIHIKU 1983: K. Bihiku, “Letërsia shqiptare e periudhës së formimit të plotë të realizmit socialist. Poezia”, në Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, Dispensa e dytë*, Tiranë, 1983, ff. 21-66, [Përse mendohen këto male, ff. 25-31].
- ÇALI 2015a: E. Çali, “Vështrim variantistik romanit *Dasma* të Ismail Kadaresë”, në “*Studime filologjike*”, 1-2, 2013, Tiranë, 2015, ff. 179-202.
- ÇALI 2015b: E. Çali, “Feja dhe variantet e autorit në romanin ‘*Dasma*’ të Ismail Kadaresë”, në *Seminari XXXIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, 34/2, Prishtinë, 2015, ff. 191-206.
- ÇALI 2016: E. Çali, “Zhvillimet gjuhësore nga variantet e autorit në veprën e Ismail Kadaresë *Dasma* 1968 dhe *Lëkura e daullës* 1980”, në *Kërkime gjuhësore IV*, Konferencë shkencore ndërkombëtare mbajtur më 10 korrik 2015, Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Shkolla doktorale në gjuhësi, Tiranë, 2016, ff. 249-259.
- ÇALI 2018: E. Çali, *Il romanzo “Dasma” di Ismail Kadare (Contributi critici e varianti d'autore)*, Vena di Jonadi, VV, 2018, ff. 522.
- KALLULLI 1968: A. Kallulli, “Shqiptari – pushka – mali. (Shënime kritike mbi poemën “Përse mendohen këto male” të I. Kadaresë), në *Artikuj kritikë (Për nxënësit e shkollës së mesme)*, Tiranë, 1968, ff. 11-36.

